



MEMORANDUM MIRËKËPTIMI
PËR STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE DHE FINANCIARE

midis

Institutit të Statistikave

dhe

Bankës së Shqipërisë

dhe

Ministrisë së Financave

TIRANË _____

Listë e shkurtimeve

MM	Memorandum Mirëkuptimi
INSTAT	Instituti i Statistikave
BSH	Banka e Shqipërisë
MF	Ministria e Financave
ESTAT	Eurostat
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
ECOFIN	Këshilli për Çështje Ekonomike dhe Financiare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
PDT	Procedura e Deficitit të Tepërt
SFQ	Statistika Financiare të Qeverisë
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BP	Bilanci i Pagesave
QP	Qeveria e Përgjithshme

PËRMBAJTJA

A. Qëllimi	4
B. Hyrje	5
C. Përkufizimi i përgjegjësisë	5
D. Prodhimi i statistikave: ndarja e detyrave	6
1. Llogaritë jofinanciare	6
2. Llogaritë financiare	7
4. Bilanci i Pagesave	8
5. Statistika financiare të qeverisë	8
6. Tabelat njoftuese për PDT	9
7. Njësitë institucionale dhe klasifikimi sektorial	10
8. Statistikat për korporatat dhe filialet e huaja	11
E. Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit	11
F. Transmetimi dhe shpërndarja e të dhënave	12
G. Organizimi i bashkëpunimit	12
H. Përditësimet	12

A. Qëllimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) rregullon marrëdhëniet midis tri agjencie statistikore, Institutit të Statistikave (INSTAT), si prodhuesi kryesor zyrtar i statistikave në Shqipëri, Bankës së Shqipërisë (BSH) dhe Ministrisë së Financave (MF), (në vazhdim "Palët"), duke përcaktuar përgjegjësitë për hartimin, shpërndarjen, transmetimin, shkëmbimin e të dhënave, si dhe fushat dhe kushtet e bashkëpunimit për prodhimin e statistikave zyrtare kombëtare nën Programin e Statistikave Zyrtare.

Përveç shkëmbimit të të dhënave, bashkëpunimi midis Palëve gjithashtu përfshin:

- a. vendimin mbi hartimin e përbashkët të planeve strategjike dhe vjetore të punës në fushën e statistikave;
- b. zhvillimin e metodave, procedurave, teknikave dhe metodologjive të reja statistikore si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese;
- c. funksionimin e komiteteve dhe grupeve të punës të ngritura për çështje specifike si dhe duke kryer shkëmbim të vazhdueshëm të dokumentave zyrtarë dhe teknikë që kanë lidhje me fushën e prodhimit statistikor.

Ky MM mbështetet në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikën zyrtare", i ndryshuar, vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 3/2013, datë 14.12.2013 "Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2012-2016", si dhe ligje e akte nënligjore të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e tyre.

Palët bien dakord të bëjnë përpjekje për minimizimin e barrës raportuese, duke lejuar shkëmbimin e nevojshëm të informacionit, të dhënave administrative, vrojtimeve, regjistrave statistikore dhe burimeve të tjera të disponuara nga secila Palë, përfshirë shkëmbimin e informacionit konfidencial statistikor, në masën e nevojshme dhe vetëm për qëllime të prodhimit të statistikave zyrtare, sipas përcaktimeve në legjislacionin kombëtar.

Secila Palë bie dakord të marrë parasysh nevojat e Palëve të tjera në hartimin e formularëve për mbledhjen e informacioneve statistikore nga agjentët e saj raportues.

Secila Palë duhet të konsultohet me Palët e tjera para formalizimit të një formulari të ri apo të rishikuar për marrje të dhënash apo të një vrojtimi statistikor që mbledh informacion që mund të jetë i dobishëm për Palët e tjera në përmbushjen e detyrave të tyre ligjore si agjenci statistikore. Formularët apo pyetësorët e vrojtimeve, sipas rastit, duhet të përmbajnë një njoftim ku të informohet njësia statistikore se informacioni statistikor i paraqitur pranë agjencisë që mbledh të dhënat, mund të ndahet me njërin ose të dyja Palët e tjera, për hartimin e të dhënave të agreguara.

Palët bëjnë përpjekje për forcimin e burimeve njerëzore dhe teknologjike duke organizuar veprimtari trajnuese si dhe nëpërmjet zbatimit të aplikacioneve *software* që lejojnë, për sa më shumë të jetë e mundur, integrimin e përputhshmërisë së bazave të të dhënave dhe burimeve statistikore nga secila Palë.

B. Hyrje

Në këtë Memorandum, Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e statistikave makroekonomike dhe financiare, të rregulluara nga ligjet kombëtare, duke zbatuar standardet e parashikuara në aktet ligjore të Bashkimit Evropian (në vazhdim BE) si dhe programet zyrtare vjetore për sistemin e statistikave kombëtare me qëllim përcaktimin e detyrave përkatëse.

C. Përkufizimi i përgjegjësisë

"Përgjegjësi" në kontekstin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të thotë e drejta dhe detyrimi për të ndërmarrë nisma për të çuar përpara zhvillimin e statistikave makroekonomike dhe financiare; për nxitjen dhe zbatimin e masave të nevojshme ligjore; për sigurimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave; për përdorimin e informacionit konfidencial të mbledhur vetëm për qëllime statistikore në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi; për veprimin si burim parësor i publikimit dhe shpërndarjes së të dhënave, sipas rastit; dhe në mirëmbajtjen e të dhënave sipas nevojave të përdoruesit dhe kushteve ekonomike dhe financiare.

"Përgjegjësi e përbashkët" do të thotë që INSTAT, BSH dhe MF marrin përgjegjësinë në një fushë të statistikave, ndërsa përkufizojnë përgjegjësitë parësore brenda kësaj fushe dhe në bashkëpunim të ngushtë sigurojnë koherencë.

Përgjegjësia dhe detyrimi i pjesëmarrësve për bashkëpunim, mbështetet në:

- 1) Ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004, "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar;
- 2) Programin 5-vjeçar të statistikave zyrtare, miratuar me vendim të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë;
- 3) Ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- 4) Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Standardet statistikore të parashikuara në *Acquis* të BE-së do të përdoren si referencë udhëzuese.

D. Prodhimi i statistikave: ndarja e detyrave

Për të siguruar zbatimin e këtij MM, Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të angazhohen në detyrat si vijon:

1. Llogaritë jofinanciare

Referuar Programit të Statistikave Zyrtare dhe në mbështetje të Rregullores 549/2013 (EU), për Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale të Komunitetit (në vazhdim: ESA2010), hartimi i llogarive jofinanciare sipas sektorëve institucionalë është përgjegjësi e INSTAT-it. Në këtë kuadër, INSTAT-i do të bashkëpunojë ngushtë me MF-në dhe BSH-në, të cilat do të japin të dhënat e nevojshme për llogaritë jofinanciare, si më poshtë:

- a. BSH-ja do t'i japë INSTAT-it të dhëna për sektorin institucional dhe nënsektorët "Korporatat financiare" si dhe për sektorët institucionalë "Pjesa tjetër e botës" në përputhje me kërkesat e ESA 2010. BSH-ja do t'i japë INSTAT-it të dhëna për Bilancin e Pagesave (BP), të nevojshme për hartimin e llogarive jofinanciare.
- b. MF-ja do t'i japë INSTAT-it të dhëna të plota 3-mujore dhe vjetore për buxhetin (idealisht të pa-axhustuara dhe të pakonsoliduara) për Qeverinë Qendrore, Qeverinë Vendore dhe Fondet e Sigurimeve Shoqërore. MF-ja do të dërgojë setin e të dhënave për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme¹, me frekuencë vjetore dhe 3-mujore, në përputhje me kërkesat e ESA 2010.

Në bashkëpunim me BSH-në, INSTAT-i do të përgatisë për sektorin e "Pjesës tjetër të botës" tabelën e konvertimit nga kategoritë e bilancit të pagesave në kategoritë e ESA 2010 duke pasur parasysh kërkesat e ESA 2010. Tabela e konvertimit në kategoritë e ESA 2010, e plotësuar me të dhënat e disponueshme, do të përgatitet me qëllim identifikimin e transaksioneve sipas sektorëve individualë dhe nënsektorëve. BSH-ja dhe INSTAT-i bien dakord për kohën për përgatitjen e tabelës së konvertimit.

Në bashkëpunim me MF-në, INSTAT-i do të përgatisë tabelën urë për konvertimin e llogarive publike të Qeverisë së Përgjithshme në llogaritë sipas ESA 2010.

¹ Qeveri e Përgjithshme përfshin (i) njësitë e qeverisjes qendrore (njësitë publike të ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit të krijuara me ligj, përfshirë edhe njësitë shpenzuese, të krijuara prej tyre); (ii) njësitë e qeverisjes vendore (ku përfshihen qarqet dhe bashkitë si edhe njësitë shpenzuese të krijuar prej tyre) dhe (iii) fondet speciale (Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor).

2. Llogaritë financiare

Statistikat vjetore të llogarive financiare në përputhje me ESA 2010 dhe llogaritë financiare 3-mujore në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane (Udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane datë 21 Nëntor 2002 për zbatimin e raportimit statistikor të Bankës Qendrore Evropiane në fushën e llogarive financiare 3-mujore ECB/2002/7) do të përgatiten nga BSH-ja. Në këtë kuadër, BSH-ja do të bashkëpunojë ngushtë me INSTAT-in dhe MF-në, të cilët do të japin të dhënat e nevojshme për llogaritë financiare si më poshtë:

- MF-ja do t'i japë BSH-së të dhënat për llogaritë financiare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në bazë 3-mujore dhe vjetore. MF-ja do t'i raportojë BSH-së të dhënat për llogaritë financiare 3-mujore dhe vjetore të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme. BSH-ja do të harmonizojë të dhënat e statistikave të llogarive financiare të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme dhe statistikave për llogaritë financiare për të gjithë sektorët e ekonomisë.
- INSTAT-i do t'i japë BSH-së të dhënat administrative të disponueshme për sektorin institucional të "Korporatave jofinanciare", "Familjeve" dhe "Institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve", në bazë vjetore, sipas kërkesave të ESA 2010.
- BSH-ja dhe INSTAT-i bashkëpunojnë për zgjerimin e të dhënave administrative me qëllim përmirësimin e mbulimit, cilësisë dhe harmonizimit të të dhënave të nevojshme jo vetëm për llogaritë financiare, por edhe për llogaritë jofinanciare për të gjithë sektorët institucionale.

Të dhënat përfundimtare të llogarive financiare për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme do t'i dërgohen INSTAT-it me qëllim publikimin e të dhënave të rakorduara për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme dhe transmetimin pranë ESTAT.

BSH-ja do të publikojë llogaritë financiare 3-mujore dhe vjetore. Llogaritë financiare vjetore do të transmetohen pranë ESTAT-it dhe BQE-së dhe llogaritë financiare 3-mujore pranë BQE-së.

3. Statistika monetare dhe financiare

BSH-ja është përgjegjëse për hartimin dhe publikimin e statistikave monetare dhe financiare. BSH-ja i jep INSTAT-it të dhëna 3-mujore për llogaritjen e Shërbimeve të Ndërmjetësimit Financiar të Matura Tërthorazi² (FISIM).

² Financial Intermediation Services Indirectly Measured (FISIM)

4. Bilanci i Pagesave

BSH-ja është përgjegjëse për bilancin e pagesave (BP), sipas Manualit për BP të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Botimi i 6^{te}, Udhëzimit për kërkesat e raportimit statistikor të Bankës Qendrore Evropiane për statistikën e bilancit të pagesave në pozicionin e investimeve ndërkombëtare dhe stokun e rezervave ndërkombëtare.

- INSTAT-i do t'i japë BSH-së të dhëna dhe informacion për eksportet dhe importet e mallrave. INSTAT-i do t'i japë BSH-së informacion shtesë nga vrojtime gjithëpërfshirëse pranë familjeve dhe sipërmarrjeve në nivel të agreguar.
- MF-ja do t'i japë BSH-së raportim të përmuajshëm për grantet dhe huatë (e disbursuara dhe të shpenzuara), asistencën teknike dhe investime të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme nga organizata ndërkombëtare apo qeveri të huaja. Gjithashtu, MF-ja i raporton kostot e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme me jashtë (shpenzime udhëtimi, shpenzime për ambasadat, pagesa për kuota ndërkombëtare, etj.).

BSH-ja do të përgatitë forma të raportimit direkt apo vrojtime të nevojshme për dhënie të informacionit për qëllime të hartimit të bilancit të pagesave, në mënyrë që të mbulohen të gjitha llojet e transaksioneve të kryera në Shqipëri nga jorezidentët si dhe nga rezidentët jashtë vendit.

BSH-ja dhe INSTAT-i do të analizojnë vazhdimisht rrezikun e dublimit të raportimit nga njësitë, për të shmangur raportimin e dyfishtë.

5. Statistika financiare të qeverisë

Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ) tregojnë aktivitetin ekonomik të qeverisë. Ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji autorizojnë MF-në për hartimin dhe shpërndarjen e statistikave financiare të qeverisë. Hartimi i Statistikave Financiare të Qeverisë mbështetet në parashikimet e Manualit të FMN-së GFSM 2014. Pyetësi SFQ do t'i jepet FMN-së nga MF-ja brenda afatit të përcaktuar nga FMN-ja dhe do të publikohet në faqen e internetit të MF-së.

INSTAT-i është përgjegjës për prodhimin dhe transmetimin e të dhënave SFQ në përputhje me ESA 2010, manuali i BE-së për llogaritë kombëtare, i plotësuar nga

interpretimi dhe udhëzimi i mëtejshëm nga Eurostat-i, në veçanti Manuali për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë³ (MGDD).

MF-ja do t'i japë INSTAT-it dhe BSH-së të dhëna të nevojshme dhe të hollësishme që disponon dhe që lejojnë konvertimin e llogarive publike të Qeverisë së Përgjithshme në përputhje me kërkesat e ESA 2010.

6. Tabelat njoftuese për Procedurën e Deficitit të Tepërt (PDT)

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në BE, ka detyrim hartimin dhe dërgimin pranë ESTAT të tabelave të njoftimeve për Procedurën e Deficitit të Tepërt (PDT). Qëllimi i kësaj pjese të Memorandumit të Mirëkuptimit është të qartësojë më tej rolet dhe përgjegjësitë si dhe fushat e bashkëpunimit midis INSTAT-it, MF-së dhe BSH-së në lidhje me hartimin dhe transmetimin e tabelave PDT.

Hartimi i raportit PDT do të përgatitet nga INSTAT-i, MF-ja, BSH-ja dhe institucione të tjera që mund të lidhen me këtë proces, në bazë të Rregullores së Këshillit 479/2009, plotësuar nga Rregullorja e Këshillit 679/2010 dhe Rregullorja e Komisionit 220/2014, në përputhje me Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë, botimi 2014. Programi i transmetimit të PDT është një proces që bëhet dy herë në vit, në zbatim të kërkesës me shkrim që dërgohet nga ESTAT pranë INSTAT-it. INSTAT-i është përgjegjës për përgatitjen e metodologjisë për PDT.

Çdo vit, INSTAT-i në bashkëpunim me MF-në dhe BSH-në, do të përgatitë një raport PDT për raportimin e 1^{te} (30 Prill) në bazë të informacionit të disponueshëm nga viti i mëparshëm dhe parashikimeve apo vlerësimeve për vitin aktual për njësitë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, bazuar në buxhetin e miratuar dhe planet financiare.

Për raportimin e 2^{te} (30 Tetor), INSTAT-i do të përgatitë një raport PDT në bashkëpunim me MF-në dhe BSH-në. Për raportimin e 2^{te} PDT sipas programit të transmetimit ESA 2010 kërkohet informacion më i hollësishëm për të dhënat e Qeverisë së Përgjithshme. MF-ja do të jetë përgjegjëse për vlerësimet e vitit aktual (parashikim) për procedurën e transmetimit të PDT.

Puna dhe përgjegjësia për hartimin e tabelave PDT do të rregullohet nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës ndërmjet INSTAT, MF dhe BSH. Të tre institucionet angazhohen të diskutojnë rregullisht çështje metodologjike për tabelën PDT dhe veçanërisht për çështje që do të kenë ndikim domethënës mbi borxhin dhe deficitet, sidomos mbi transaksionet e reja dhe ndryshimet në trajtimin e disa zërave.

³Manual on Government Deficit and Debt (MGDD)

Të gjitha Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu me ESTAT, në veçanti në kontekstin e Dialogut PDT në lidhje me çdo vizitë që mund të vijë sipas rastit.

7. Njësitë institucionale dhe klasifikimi sektorial

INSTAT-i është përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të njësive institucionale dhe për përkufizimin e klasifikimit të tyre në linjë me metodologjinë ESA 2010, duke respektuar parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

INSTAT-i do të bashkëpunojë me MF-në për identifikimin dhe klasifikimin e njësive institucionale të qeverisë sipas sektorëve dhe nënsektorëve. MF-ja do të jetë përgjegjëse për dhënien e informacionit për krijimin dhe përditësimin e listës së njësive institucionale, njësive buxhetore, etj. Të dy institucionet do të bashkëpunojnë për përgatitjen dhe publikimin e një liste unike me njësitë institucionale të sektorit publik të klasifikuar sipas ESA 2010.

INSTAT-i do të bashkëpunojë me BSH-në për identifikimin dhe klasifikimin e njësive institucionale financiare sipas sektorëve dhe nënsektorëve. BSH-ja do të jetë përgjegjëse për dhënien e informacionit në lidhje me hartimin dhe përditësimin e klasifikimit të njësive institucionale financiare konform ndarjes sektoriale të ESA 2010.

INSTAT-i duhet të informohet nga MF-ja dhe BSH-ja në rastet e mëposhtme:

- a. Nëse kanë informacion që çon në ndryshim të klasifikimit të njësive institucionale qeveritare ose financiare, MF-ja dhe BSH-ja informojnë menjëherë INSTAT-in. INSTAT-i do ta përkufizojë klasifikimin përfundimtar në bashkëpunim me Palët, sipas kërkesave të ESA 2010.
- b. Nëse krijohen njësi të reja institucionale apo del ndonjë shkrimje e njësive institucionale, MF-ja dhe BSH-ja duhet t'i japin informacion INSTAT-it me qëllim klasifikimin ose riklasifikimin sipas kërkesave të ESA 2010.

Në rast vështirësie për klasifikimin e një njësie institucionale, ose Palët nuk bien dakord me vendimin e INSTAT-it, Palët bien dakord të kërkojnë ekspertizë nga ESTAT.

INSTAT-i do të njoftojë Palët nëse ka ndonjë ndryshim në klasifikimin e njësive institucionale të korporatave jofinanciare, individëve dhe organizatave jofitimprurëse që u shërbejnë individëve.

Regjistri i përditësuar i njësive institucionale sipas klasifikimit të sektorëve do të përdoret nga secili prej pjesëmarrësve me qëllim prodhimin e statistikave gjithëpërfshirëse dhe konsistente për të gjithë sistemin e llogarive.

8. Statistikat për korporatat dhe filialet e huaja

BSH-ja dhe INSTAT-i do të bashkëpunojnë për angazhimin e raportimit të të dhënave për sipërmarrjet dhe filialet e huaja rezidente dhe për sipërmarrjet dhe filialet shqiptare jashtë vendit. Angazhimi për raportimin e këtyre të dhënave kryhet në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit 716/2007 "Për statistikat e komunitetit për strukturën dhe veprimtarinë e filialeve të huaja". INSTAT-i do të jetë përgjegjës për transmetimin e të dhënave për sipërmarrjet dhe filialet vendase ("*inward Enterprises and affiliates*"), ndërsa BSH-ja do të jetë përgjegjëse për transmetimin e të dhënave për sipërmarrjet dhe filialet e huaja ("*on outward Enterprises and affiliates*"). Të dy institucionet do të bashkëpunojnë në përgatitjen e legjislacionit dhe në projektin pilot.

E. Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit

Për qëllime të këtij Memorandumi, sistemi i shkëmbimit të të dhënave midis pjesëmarrësve do të jetë brenda Sistemit Kombëtar Statistikor dhe në përputhje me nenin 16, të Ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar. Shkëmbimi i të dhënave do të bëhet në bazë të urdhrave të përbashkët ndërmjet Palëve dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Në përputhje me ligjin për statistikat zyrtare, të dhëna statistikore individuale do të shkëmbehen për qëllime të zbatimit të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare. Pjesëmarrësit do të përdorin të dhëna të marra në mënyrë ekskluzive brenda Sistemit Kombëtar Statistikor për zbatimin e programeve të kërkimit statistikor dhe nuk duhet t'u transmetohen palëve të treta.

Palët bien dakord gjithashtu që:

- të shkëmbejnë informacion për takimet e planifikuara ndërkombëtare të organizuara në lidhje me statistikën e mësipërme (Komisioni Evropian, BQE, etj.) dhe, nëse është e nevojshme, do të konsultohen me njëri-tjetrin për çështje që kanë të bëjnë me qëndrime individuale;
- të shkëmbejnë informacion për konferencat, trajnimet dhe seminarët e planifikuara dhe, nëse është e nevojshme, do të organizojnë dhënie të njohurisë së fituar nga pjesëmarrja në trajnime, konferenca dhe seminare;
- të ndajnë konkluzione, raporte dhe materiale të tjera nga mbledhjet, pjesëmarrje në trajnime konferenca dhe seminare;

- të shkëmbejnë shpjegime dhe metodologji për llogaritjen e statistikave që do të ndihmojnë për sigurimin e transparencës dhe konsistencës së statistikave;
- të japin asistencë për trajnimin e personelit.

F. Transmetimi dhe shpërndarja e të dhënave

Pjesëmarrësit do të shpërndajnë dhe publikojnë statistika financiare dhe makroekonomike të agreguara në përputhje me këtë Memorandum dhe aktet ligjore, brenda afateve të përcaktuara nga ligjet e BE-së. INSTAT-i do të informojë përdoruesit për të dhënat e mbledhura dhe të publikuara nga BSH-ja dhe MF-ja në faqen e vet të internetit.

Pjesëmarrësit kanë përgjegjësinë t'i shoqërojnë statistikat me metadatat e duhura. Palët do t'u përgjigjen pyetjeve mbi të dhënat e tyre, sipas përgjegjësisë të parashtruara më lart. Diskutimet mund të çojnë në amendime të të dhënave të paraqitura më parë, sipas procedurave të rena dakord.

G. Organizimi i bashkëpunimit

INSTAT-i, BSH-ja dhe MF-ja bashkëpunojnë nëpërmjet ngritjes së grupeve të punës, pjesëmarrjes në takime etj.

Brenda një muaji nga data e nënshkrimit të këtij memorandumi, Palët bien dakord të ngrenë grupe ndërinstitucionale pune për SFQ, tabelat e PDT dhe statistikat e llogarive jofinanciare dhe financiare.

Objekti, detyrat, përgjegjësitë e anëtarëve dhe mënyra e funksionimit të grupeve të punës të lartpërmendura dhe/ose grupeve të tjera, do të përcaktohen nëpërmjet urdhrave të përbashkët ndërmjet Palëve, për zbatimin e këtij Memorandum Mirëkuptimi.

Për aq sa është e mundur, mosmarrëveshjet midis INSTAT-it, BSH-së dhe MF-së për interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhen në nivel teknik pune. Në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje në këtë nivel, drejtuesit e INSTAT-it, BSH-së dhe MF-së do të bëjnë përpjekje për zgjidhjen e çështjes.

H. Përditësimet dhe ndryshimet

Me kërkesë të ndonjërës prej Palëve, INSTAT, MF dhe BSH mund të rishikojnë dhe përditësojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi nëpërmjet shtojcave.

Çdo ndryshim në këtë memorandum do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e të tre palëve.

Në rast kur përmbushja e parashikimeve të kësaj marrëveshje shoqërohet me kosto financiare, palët do të angazhohen për marrjen përsipër të tyre respektivisht, në përputhje me rregullat e tyre institucionale.

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët për një afat të pacaktuar.

Secila nga palët mund të zgjidhë këtë Marrëveshje nga efektet në çdo kohë, duke njoftuar paraprakisht palët e tjera.

Kjo marrëveshje hartohet në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, 2 (dy) kopje për secilën palë.

Për
Ministrinë e Financave
ARBEN AHMETAJ
MINISTER

Nr. 12380 Prot.

Datë 15/9 /2016

Për
Bankën e Shqipërisë
GENT SEJKO
GUVERNATOR

Nr. 4523 Prot.

Datë 26/09 /2016

Për
INSTAT
MIRELA MUÇA
DREJTOR I
PËRGJITHSHËM
TIRANË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 1146 Prot.

Datë 03/10 /2016